e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica.

Burimet: *Dnevnik od 22. do 25. decembra*, Ilustrovana politika, FDH-32300; KKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri..*, 58, FDH-8817; FDH, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, II, 894; SMIP, *Teroristički..*, III, 941.

Gani (Mustafa) Gushani
(19.11.1944, rom nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Ilmi (Hasan) Gushani
(5.07.1972, rom nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Basri (Riza) Gushani
(7.11.1975, rom nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Ganiu ishte delegat në Kuvendin e Komunës në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Në datën **27.12.1998,** rreth orës 18:45, në pjesën jugore të **Mitrovicës/Kosovska Mitrovica**, në *Lagjen e Sitnicës/Sitničko naselje,* Rruga *Shtatë Minatorë*, tre pjesëtarët e UÇK-së kanë shtënë, duke vrarë Ganiun, Ilmiun dhe Basriun në oborrin e shtëpisë familjare. Një ditë më parë, Ilmiu, Ganiu dhe Basriu ishin lajmëruar për pjesëtarë të sigurimit lokal, të themeluar nga pushteti serb.

Burimet: *Dnevnik od 26. decembra do 3. januara*, Ilustrovana politika, FDH-32302; USCG KGDH, *Regjistri..*, 61, FDH-8817; FDH, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, II, 894; SMIP, *Teroristički..*, III, 271; KKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832.

Fatmir (Ferat) Abazi
(20.12.1970, shqiptar nga Klladërnica/Kladernica, komuna e Skënderajt/Srbica, student, i pamartuar)

Në datën 20.12.1998, Fatmiri ka shkuar në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica në vizitë te djemtë e hallës. I kaloi atje dy ditë dhe më pas u nis në shtëpi. Në të njëjtën ditë, farefisi i tij ka mësuar se policia serbe e kishte arrestuar një person [**Mitrovicë/Kosovska Mitrovica**]. Sipas përshkrimit të këtij personi, ata kanë dyshuar se bëhej fjalë për Fatmirin. Nuk patën guxim të shkonin në polici. Në datën **28.12.1998**, atyre iu paraqit një njeri dhe u tha se në morg gjendet trupi i një personi nga Klladërnica/Kladernica. Më vonë, policia ia ka dorëzuar babait të Fatmirit trupin e të birit. Në trup shiheshin plagët nga keqtrajtimi fizik. Familjarët e kanë varrosur Fatmirin në varrezat e Klladernicës/Kladernica.

Burimet: deklarata L.A, FDH-40630; J. Osmani, *Krimet..*, II, 288.

Shemsi (Fejzullah) Balinci
(28.05.1965, shqiptar nga Vushtrria/Vučitrn)

Nuhi (Mehmet) Rrahmani
(12.07.1971, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Shemsiu dhe Nuhiu u vranë më **29.12.1998**, nën urë, në rrugën magjistrale Mitrovicë/Kosovska Mitrovica – Prishtinë/Priština, në fshatin **Shupkofc/Šupkovac**. Tri ditë më parë, policia i kishte bastisur shtëpitë e tyre.

Burimet: deklarata Xh.R, FDH-34346; *Dnevnik od 26. decembra do 3. januara*, Ilustrovana politika, FDH-32302; KKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P00407, FDH-31176; *Pronađen leš NN mladića,* Politika, 28.01.1999, FDH-16126; *Albanians Killed in Mitrovica Were Persued as Terrorists by Serb Police*, pasqyra e lajmeve, KIC, 30.12.1998, FDH-30868.